



ГРАДЕЊЕ НА УСЛУГИ ЗАСНОВАНИ НА ЗАЕДНИЦАТА
ЗА ПОДДРШКА НА РЕСОЦИЈАЛИЗАЦИЈА И
РЕИНТЕГРАЦИЈА НА ПОРАНЕШНО ОСУДЕНИ ЛИЦА

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021-2025)

Periudha e monitorimit:
viti 2024



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



МЗМП



Наслов на оригиналот:

МОНИТОРИНГ НА СПРОВЕДУВАЊЕ НА СТРАТЕГИЈАТА НА РАЗВОЈ НА ПРОБАЦИСКА СЛУЖБА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА (2021-2025)

Период на следење: 2024 година

Преведено од македонски на албански јазик:

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021 – 2025)

Periodha e monitorimit: viti 2024

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Përfaqësuar nga:

Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktore:

Urani Pirovska

Autore:

Aleksandra Trajanovska

Përkthimi në shqip:

Shenasi Jaji

Lektore:

Violeta Tancheva - Zlateva

Viti i botimit:

2025

Vendi i botimit:

Shkup

Numri i faqeve:

32

Dizajni grafik:

Masiva Creative Agency



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



МЗМП



Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e MZMP dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA	5
HYRJE	6
RRETH PROJEKTIT	8
METHODOLOGJIA	10
GJETJET NGA MONITORIMI	13
Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e zbatimit të sanksioneve dhe masave alternative	13
Rezultati 1.1. Analizë e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative	13
Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për rritjen e numrit të sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara	13
Rezultati 1.2.1. Zgjerimi i zbatueshmërisë së punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal	13
Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës Penale	14
Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha e mbikëqyrjes dhe e mbështetjes për personat me lirim me kusht nga shërbimi i probacionit	14
Rezultati 1.3. Ndryshimet në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit	14
Rezultati 1.4. Akte nënligjore të kompletuara dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit	14
Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për të miturit	15
Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale	16
Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë punët e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave	16
Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit	16
Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor	16
Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxhet për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit	17

Rezultati 3.3. Hartimi i planit vjetor të trajnimit për nëpunësit e probacionit, i cili përditësohet rregullisht	17
Rezultati 3.4. Trajnimi bazë i rregullt do të kryhet për të gjithë nëpunësit e probacionit	18
Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh	18
Rezultati 3.6. Trajnime të përbashkëta për vendosjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse	18
Rezultati 3.7. Trajnime për trajnuesit	18
Veprimi – Avancimi i veprimit/trajnit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative	19
Rezultati 1.2.4. Të rritet numri i sanksioneve alternative dhe të zvogëlohet numri i sanksioneve alternative të ankimuara	19
Rezultati 4.3. Rritja e numrit të aktgjykimeve për shërbim në komunitet	19
Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit	24
Rezultati 5.2. Mbajtja e tryezave të rregullta në nivel qendror dhe në të gjitha rajonet me përfaqësues të autoriteteve gjyqësore dhe partnerë nga rrjeti i bashkëpunëtorëve	24
Rezultati 5.3. Vendosja e protokolleve të bashkëpunimit dhe listave të partnerëve për bashkëpunim që përditësohen rregullisht	24
Rezultati 5.4. Përgatitja e mëtutjeshme e memorandumeve të bashkëpunimit me komunat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punëve të dobishme në komunitet	25
Rezultati 5.5. Organizimi i tryezave të rregullta të shërbimit të probacionit dhe shërbimit të burgjeve në të gjitha fushat, në kuadër të institucioneve penitenciare dhe përcaktimi i procedurave standarde të punës për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit	25
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	26
Rekomandime për përmirësimin e sistemit të sanksioneve alternative dhe probacionit në Maqedoninë e Veriut	27
Korniza ligjore për sanksionet dhe masat alternative	27
Korniza institucionale dhe kapacitetet e shërbimit të probacionit	27
Veprimi dhe zbatimi i masave alternative	30
Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe organizatat e shoqërisë civile	28
LITERATURA E PËRDORUR	29
Shtojca 1 – Matrica e monitorimit	30

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

KP – KODI PENAL

LPP – LIGJI I PROCEDURËS PENALE

RMV – REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

DES – DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

KGjRMV – KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PPRMV – PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

OQ – ORGANIZATA QYTETARE

ENER – REGJISTRI KOMBËTAR ELEKTRONIK I AKTEVE TË RMV-së

PSO – PROCEDURA STANDARDE OPERACIONALE

HYRJE

Shërbimi i probacionit është një njësi e veçantë organizative e krijuar në kuadër të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve pa privim nga liria, më saktë të masave alternative: dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, punë në dobi të përgjithshme dhe burg shtëpiak, si dhe ekzekutimin e lirimit me kusht, të shqiptuara me aktvendim gjykatë. Shërbimi i probacionit mbikëqyr personat e dënuar dhe u ofron atyre mbështetje, ndërsa synimi është ruajtja e sigurisë në komunitet duke përmirësuar risocializimin dhe riintegrimin e personave për të cilët kryhen punë probacioni, si dhe reduktimin e numrit të personave të burgosur. Shërbimi i probacionit është përgjegjës edhe për përgatitjen e raporteve për vlerësimin e rrezikut të personave të pandehur gjatë procedurave gjyqësore me propozimin për llojin e sanksionit penal për të pandehurin. Shërbimi i probacionit është një pjesë thelbësore e sistemit modern të drejtësisë penale dhe synon të kontribuojë në uljen e mbipopullimit të sistemit të burgjeve, duke shqiptuar njëkohësisht dënimet e duhura për shkelësit, duke i sfiduar ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës.

Në vitin 2021 është hartuar Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021- 2025 (në tekstin e mëtejme: Strategjia), e cila parasheh një gamë të gjerë të rezultateve që duhet të përmbushin shumica e institucioneve kompetente. Strategjia është një dokument strategjik gjithëpërfshirës që ofron një udhërrëfyes për reformat që duhen bërë në periudhën e ardhshme.

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë më hollësisht zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem të pavarur monitorimi. Vetë probacioni, në fakt, nënkupton vendosjen e një sistemi efikas të sanksioneve dhe mekanizmave mbrojtës që kontribuojnë në uljen e krimit, rritjen e mbrojtjes/sigurisë së shoqërisë dhe sigurisë publike, si dhe në risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar.

Në periudhën gjatë vitit 2024, zbatimi i Strategjisë parashikon përgatitjen dhe miratimin e rregulloreve (ligjeve, ndryshimeve ligjore dhe akteve të tjera), zbatimin e aktiviteteve specifike (p.sh. rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të shërbimit të probacionit etj.), si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit (mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta me institucionet përkatëse, takime tremujore etj.).

Plani i veprimit i Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përcakton aktivitetet në kuadër të secilit qëllim dhe rezultat të përcaktuar me Strategjinë, gjithashtu përcakton edhe afatin kohor dhe treguesit për përmbushjen e tyre. Në këtë drejtim, qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Gjithashtu, analiza do të vlerësojë nëse rezultatet dhe aktivitetet janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me kornizën kohore, cila është cilësia e tyre dhe dinamika dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër, do të analizohet edhe ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut, kështu që në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë, Analiza do të ofrojë edhe konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të probacionit.

Vëzhgimi, si sistem i pavarur monitorimi, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në këtë Strategji.

RRETH PROJEKTIT

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Krijimi i shërbimeve mbështetëse në komunitet nëpërmjet risocializimit dhe riintegrit të ish-personave të dënuar”, financuar nga Bashkimi Evropian. Për qëllime të projektit, u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Shoqatës Penologjike Maqedonase, Shoqatës për këshillim, trajtim, riintegrim dhe risocializim të personave të varur nga substancat psikoaktive IZBOR, dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të zvogëlojë recidivizmin dhe cenueshmërinë e personave të dënuar pas lirimit të tyre, duke forcuar politikat dhe shërbimet për risocializimin, riintegrimin dhe kujdesin pas-penal të tyre në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.

Qëllimet specifike që synon projekti:

- Të përmirësojë cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve të mbrojtjes penale dhe pas-penale me qëllim të risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar, personave të dënuar më parë, si dhe personave të dënuar me kusht;
- Të rritet kapaciteti dhe bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet institucioneve penale, gjykatave, nëpunësve të probacionit, qendrave të punës sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për risocializim, probacion dhe mbrojtje pas-penale;
- Të përmirësohet korniza ligjore dhe politikat për risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, të dënuar më parë, si dhe të personave për të cilët kryhen punë probacioni, bazuar në hulumtimet dhe praktikat më të mira.

Objektivat e projektit do të arrihen përmes një grupi të ndërlidhur prej tre komponentësh:

Ofrimi i shërbimeve që përfshin aktivitete për krijimin e një shërbimi kombëtar mbështetës për risocializimin dhe rehabilitimin e të burgosurve në partneritet midis OQ-ve (organizatave qytetare) dhe DES-it (Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve), i cili do të ofrojë mbështetje para dhe pas lirimit (juridik, psikosocial, trajtim për karrierën dhe varësinë). Nëpërmjet këtij komponenti, projekti do të pilotojë një program për lehtësimin e punësimit të ish-personave të burgosur, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit dhe sektorin e biznesit.

Komponenti **Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi** parashikon zhvillimin e një planprogrami mësimor dhe materialesh trajnimi, zbatimin e një programi trajnimi për gjyqtarët, këshilltarët e burgjeve, nëpunësit e probacionit, punonjësit socialë dhe ofruesit e shërbimeve, organizimin e seminareve rajonale për përcaktimin e kushteve për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe krijimin dhe ofrimin e mbështetjes për tre ekipe lokale të koordinuara ndërinstitucionale. Monitorimi i zhvillimit të shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021 – 2025 është pjesë e komponentit të tretë, **Korniza për hulumtim dhe politika**, e cila gjithashtu do të ofrojë mbështetje për zhvillimin e dy PSV-ve (procedurave standarde të veprimit), organizimin e konferencave dhe zhvillimin e dokumenteve të politikave.

METODOLOGJIA

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë më në detaje zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem të pavarur monitorimi. Gjithashtu, në atë drejtim, analiza do të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Do të vlerësohet nëse rezultatet dhe aktivitetet janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me afatin kohor, cila është cilësia dhe dinamika e tyre dhe bashkëpunimi ndërinstitutional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër do të analizohet ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë do të nxirren konkluzionet kryesore se çfarë është zbatuar dhe çfarë ka munguar dhe cilat janë pengesat kryesore për këtë dhe do të ofrohen rekomandime për zbatimin e mëtejshëm të Strategjisë.

Fokusi i monitorimit janë katër tema, përkatësisht:

- Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e zbatimit të sanksioneve dhe masave alternative;
- Korniza institucionale – Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale;
- Trajtimi/Veprimi – Përmirësimi i veprimit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional në fushën e probacionit.

Brenda këtyre katër elementeve, sipas një matrice monitorimi të paracaktuar (Aneksi 1), subjekt i monitorimit do të jenë:

- Vlerësimi i zbatimit të rezultateve;
- Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve;
- Vlerësimi i dinamikës së zbatimit të aktiviteteve specifike;
- Vlerësimi i nivelit të përfshirjes së aktorëve kryesorë;
- Vlerësimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së aktiviteteve të kryera;
- Vlerësimi i ndikimit mbi të drejtat e njeriut për çdo aktivitet.

Monitorimi, si sistem i pavarur përpërcjellje, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në Strategji. Monitorimi do të vlerësojë gjithashtu realizimin e rezultateve të pritshme të përcaktuara në Strategji dhe zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit në lidhje me katër temat që janë objekt monitorimi.

Monitorimi do të kryhet nëpërmjet nën-aktiviteteve të mëposhtme:

1. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat do të mblidhen në disa mënyra, duke përfshirë:

- shqyrtimin dhe analizën e dokumenteve, strategjive, ligjeve, akteve nënligjore, raporteve në fushën e probacionit;
- kërkesat për qasje të lirë në informacionin publik tek institucionet përkatëse (Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, zyrat e probacionit, gjykatat);
- intervistat gjysmë të strukturuar dhe fokus grupet me nëpunësit e probacionit, gjyqtarët dhe të dënuarit me kusht, Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, si dhe institucione të tjera përkatëse.

2. Njoftimi dhe publikimi

Si rezultat i monitorimit, do të përgatiten dhe publikohen gjashtë raporte, ku do të përvijohen gjetjet kryesore nga procesi i monitorimit. Nga raportet do të përgatiten infografikë, në mënyrë që të prezantohen më lehtë të gjeturat e rezultuara nga monitorimi.

3. Promovimi i gjetjeve

Raportet do të ndahen me institucionet përkatëse dhe do të jenë të disponueshme publikisht në faqet e internetit të partnerëve të projektit.

4. Diskutimi i gjetjeve

Gjetjet e secilit raport do t'u prezantohen palëve kryesore të interesit në tryeza të rrumbullakëta. Çdo institucion do të ftohet të japë komente në lidhje me gjetjet e raportit. Ngjarjet do të sigurojnë që të gjitha institucionet përkatëse të jenë të vetëdijshme për shkallën e zbatimit të strategjisë, si dhe për problemet që mund të ndikojnë në reformat në sektorin e probacionit.

5. Reagimi/Avokimi

Si përjashtim, nëse identifikohen gjetje të caktuara specifike që kërkojnë veprime urgjente dhe të menjëhershme, do të përgatiten njoftime për të gjitha institucionet përkatëse dhe do të ndërmerren aktivitete avokuese për të përcaktuar problemet.

Raporti i tretë do të analizojë rezultatet dhe aktivitetet në lidhje me katër temat, d.m.th. ato që planifikohen të zbatohen gjatë vitit 2024. Plani i veprimit i Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përcakton aktivitetet në kuadër të secilit qëllim dhe rezultat të përcaktuar nga Strategjia, si dhe një afat kohor dhe tregues që duhet t'i zbatojnë Ministria e Drejtësisë, zyrat e shërbimit të probacionit dhe organet e tjera të shërbimit gjyqësor deri në vitin 2024.

Ky është raporti i tretë dhe i fundit në serinë e raporteve dhe është përgatitur sipas të njëjtës metodologji si dy raportet e mëparshme që mbulojnë periudhën e viteve 2021, 2022 dhe 2023.

GJETJET NGA MONITORIMI

Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e zbatimit të sanksioneve dhe masave alternative

Rezultati 1.1. Analizë e nevojave për ndryshime të kornizës ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative

Ky rezultat i Strategjisë¹ është përmbushur në periudhën 2021-2022 kur grupi i punës kreu një analizë të nevojave për ndryshime në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" pas mbajtjes së katër tryezave të rrumbullakëta me temën "Analiza e nevojave për ndryshime ligjore", për të cilën u përgatit një raport i Rregullores. Shërbimi i Probacionit ka ofruar propozime për grupet e punës që punojnë për ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe është e nevojshme miratimi i ndryshimeve në ligjet sistematike dhe më pas përafrimi i ligjit të probacionit me to.

Rezultati 1.2. Ndryshimi i kornizës ligjore për të rritur numrin e sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara

Në fushën e zhvillimit të kornizës ligjore në fushën e zbatimit të sanksioneve dhe masave alternative, Strategjia parasheh ndryshime në Kodin Penal dhe Ligjin për Procedurën Penale. Këto ndryshime do të bazohen në analizat e përgatitura nga grupi i ngritur i punës dhe listën e propozimeve nga projekti i Binjakëzimit "Forcimi i Sistemit të Burgjeve dhe Zhvillimi i Shërbimit të Probacionit", i cili u zbatua në periudhën 2018- 2020 nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve. Kjo listë i referohet rezultateve të dhëna në vazhdim të tekstit (Rezultati 1.2.1; Rezultati 1.2.2; Rezultati 1.2.3).

Rezultati 1.2.1. Zgjerimi i zbatueshmërisë së punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal

Në periudhën e monitorimit që përfundon në vitin 2024, nuk janë miratuar ende ndryshimet ligjore në Kodin Penal që kanë të bëjnë me zgjerimin e zbatueshmërisë së

¹ Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025).

shërbimit komunitar për të rritur mundësinë e përfshirjes në këtë masë të të kthyerve që përjashtohen automatikisht nga sanksionet alternative.

Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Kodin e Procedurës Penale

Ndryshimet dhe harmonizimi i Ligjit për Procedurën Penale me Kodin Penal janë gjithashtu pjesë e rezultateve të parapara me Strategjinë me qëllim të harmonizimit të dy ligjeve në fushën e përdorimit të sanksioneve dhe masave alternative. Gjatë vitit 2024, këto ndryshime ligjore ende nuk janë miratuar.

Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha e mbikëqyrjes dhe e mbështetjes për personat me lirim me kusht nga ana e shërbimit të probacionit

Praktika tregon se në shumicën e rasteve afati kohor prej 3 muajsh është shumë i shkurtër që shërbimi i probacionit të mund të ofrojë mbështetje dhe mbikëqyrje efektive ndaj personave që lirohen me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Për këtë qëllim, Strategjia parashikon ndryshime në Kodin Penal që do të parashikojë një periudhë më të gjatë të mbështetjes dhe mbikëqyrjes së shërbimit të probacionit, me qëllim uljen e rrezikut të recidivizmit dhe zbatimin efikas të mbështetjes për risocializimin e suksesshëm të personave të dënuar. Ky rezultat ende nuk është arritur plotësisht gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë.

Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit

Në vitin 2024 ishin parashikuar ndryshime në Ligjin e probacionit që do të forconin pozitën e nëpunësve të probacionit dhe do të zgjeronin hapësirën e përdorimit të shërbimit të probacionit në procedimet penale dhe ekzekutimin e sanksioneve. Procesi ka nisur dhe është formuar një grup pune në fund të vitit 2024.

Rezultati 1.4. Akte nënligjore të kompletuara dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit

Ky rezultat i paraparë në Strategji do të fillojë të zbatohet kur të bëhen ndryshimet e parapara ligjore në Ligjin për probacion.

Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për të miturit

Shërbimi i probacionit, në përputhje me Ligjin e Probacionit, punon vetëm me autorë të rritur të krimeve. Strategjia parashikon një analizë të zgjerimit të mundshëm të kompetencave të shërbimit dhe drejtësisë për të mitur, megjithatë këto aktivitete janë shtyrë për të forcuar fillimisht pozitën e shërbimit të probacionit në sistemin penal. Për një analizë të suksesshme të nevojave për ndryshimin e kornizës ligjore dhe procedurave të punës për të mbështetur dënimin me kusht dhe sanksionet alternative për të miturit, është e nevojshme përfshirja e organizatave ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe sundimin e ligjit. Prandaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë nuk është arritur në periudhën e monitorimit në vitin 2024.

Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale

Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë punët e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave

Shërbimi i probacionit ka 11 zyra funksionale të probacionit që janë krijuar në vitin 2022. Gjatë vitit 2024 nuk do të ketë hapje të zyrave të mbetura që ishin planifikuar në Strategjinë e zhvillimit të shërbimit të probacionit. Ajo që mund të theksojmë si domethënëse është se në baza vjetore mund të vërehet një rritje e rasteve të probacionit, pra për vitin 2023 ai numër ishte 483 lëndë probacioni, ndërsa në vitin 2024 ai numër ishte 793 lëndë probacioni. Shifrat janë pothuajse dyfishuar, gjë që nuk ka ndodhur në vitet e mëparshme të procesit të monitorimit.

Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit

Duke marrë parasysh se ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin e Probacionit janë në proces pune, përmbushja e këtij rezultati të Strategjisë nuk është zbatuar. Për të vazhduar me zhvillimin e procedurave standarde operative, fillimisht është e nevojshme që ndryshimet në Ligjin për Përmbarim dhe Ligjin për Probacion të hyjnë në fuqi. Në kuadër të projektit të binjakëzimit “Forcimi i Sistemit Penitenciar dhe Zhvillimi i Shërbimit të Probacionit”, janë zhvilluar procese dhe protokolle për punën e shërbimit të probacionit.

Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor

Në përputhje me metodologjinë e punësimit, shërbimi i probacionit duhet të ketë gjithsej 90 nëpunës probacioni të cilët do të punësohen në periudhën 2021- 2025. Në vitin 2024, shërbimi i probacionit do të ketë 29 nëpunësprobacioni.

ZYRA E PROBACIONIT	BASHKËPUNËTORE TË RINJ	BASHKËPUNËTORE TË LARTË	KËSHILLTARË	ARKIVIST PËR PROBACION	UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR MBIKËQYRJË MBI KRYERJEN E PUNËVE TË PROBACIONIT
Sektori për probacion në DES	1	2	/	1	1
Shkup	5	1	3	/	/
Kumanovë	2	/	1	/	/
Manastir	2	/	/	/	/
Strumicë	/	1	/	/	/
Shtip	2	/	/	/	/
Ohër	1	/	/	/	/
Veles	1	/	/	/	/
Prilep	2	/	/	/	/
Kavadar	1	/	/	/	/
Gjevgjeli	/	/	/	/	/
Tetovë	3	/	/	/	/
GJITHSEJ	19	4	4	1	1

* Zyra e probacionit në Gjevgjeli nuk ka punonjës të punësuar dhe lëndët në atë zonë trajtohen nga zyra e probacionit në Strumicë.

Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe krijimi i një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunimin me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit

Qendra e trajnimit të shërbimit të burgjeve pranë DES-it është krijuar dhe është në dispozicion për të zhvilluar trajnime për punonjësit e sistemit të burgjeve, përfshirë shërbimin e probacionit. Plan i vjetor i trajnimit të Shërbimit të burgjeve parashikon disa trajnime bazë për nëpunësit e probacionit të sapopunësuar dhe një sesion trajnimi të vazhdueshëm.

Rezultati 3.3. Hartimi i planit vjetor të trajnimit për nëpunësit e probacionit, i cili përditësohet rregullisht

Me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe aftësive të nëpunësve të probacionit, Strategjia parashikon përgatitjen e një plani trajnimi vjetor nga Shërbimi i probacionit. Janë planifikuar module të veçanta që do të jenë pjesë e programit të trajnimit për punonjësit në sistemin penitenciar. Disa nga nëpunësit e probacionit janë të trajnuar për të punuar në Qendrën e trajnimit, nuk ka punonjës të caktuar posaçërisht.

Rezultati 3.4. Trajnimi bazë i rregullt do të kryhet për të gjithë nëpunësit e probacionit

Strategjia parasheh mbajtjen e trajnimeve bazë dhe speciale për nëpunësit e probacionit. Në vitin 2024, në kuadër të projektit “Mbështetja e Sundimit të Ligjit”, u zbatua trajnimi për shkelësit e varur nga droga, alkooli dhe lojërat e fatit për të gjithë nëpunësit e probacionit. Gjithashtu, 13 nëpunës të probacionit, të cilët janë pjesë e grupit të punës të PR-it iu nënshtruan trajnimit për komunikim në krizë dhe intervista në media.

Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh

Në vitin 2024 janë mbajtur dy trajnime të specializuara në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit”. Trajnimi i parë ishte për shkelësit e rrezikut të lartë për të gjithë nëpunësit e probacionit, kurse trajnimi i dytë ishte për punën me persona të pamotivuar nën mbikëqyrje probacioni për të gjithë nëpunësit e probacionit.

Rezultati 3.6. Trajnime të përbashkëta për vendosjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse

Në vitin 2024, në kuadër të projektit “Krijimi i shërbimeve komunitare për mbështetjen e risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar më parë” i zbatuar nga Ministria e Drejtësisë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqata Penologjike Maqedonase dhe Shoqata Izbor, nëpunësit e probacionit morën pjesë në trajnime të përbashkëta rajonale me punonjës të sektorëve të risocializimit dhe qendrave për punë sociale.

Rezultati 3.7. Trajnim për trajnues

Në vitin 2024, 10 nëpunës probacioni përfunduan një kurs trajnimi për trajnues të zbatuar në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit”.

Veprimi – Avancimi i veprimit/trajtimin dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative

